LIGJ
Nr.10 479, datë 10.11.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 233, DATË 11.2.2010 "PËR AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL"

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 6 "Kompetencat e këshillit drejtues" bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën "c" fjala "të departamenteve" zëvendësohet me fjalën "të sektorëve".

2. Shkronjat "d" dhe "dh" ndryshohen si më poshtë:

"d) miraton programin financiar të Autoritetit dhe ndryshimet e tij, për të cilin informon ministrin, si dhe mbikëqyr realizimin e tij;

dh) propozon te ministri masën e tarifave që do të zbatohen nga Autoriteti, sipas pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, për shërbimet që kryen, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon çështjet e transportit dhe të Ministrit të Financave;".

Neni 2

Në nenin 13 "Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv" bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronjat "c", "ç", "d", "dh" dhe "ë" ndryshohen si më poshtë:

"c) paraqet për miratim në këshillin drejtues programin ekonomiko-financiar të Autoritetit dhe çdo ndryshim të tij;

ç) paraqet për miratim në këshillin drejtues vlerat e tarifave që do të zbatohen për të gjitha autorizimet, certifikimet dhe licencat, që lëshon ky Autoritet;

d) përcakton dhe paraqet për miratim në këshillin drejtues kërkesat dhe përshkrimet e punës për çdo pozicion, kriteret e punësimit të personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përparësitë e Autoritetit dhe me rregulloren e tij të brendshme;

dh) emëron dhe shkarkon personelin e Autoritetit, sipas procedurave të përcaktuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe ndërkohë informon këshillin drejtues për emërimet dhe shkarkimet përkatëse;

ë) ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrat për të siguruar plotësimin e detyrimeve që i janë ngarkuar Autoritetit, në zbatim të Kodit Ajror, dhe nënshkruan të gjitha autorizimet, lejet, licencat e kategorizimet;".

2. Pas shkronjës "ë" shtohen shkronjat "f", "g" dhe "gj" me këtë përmbajtje:

"f) miraton programet e trajnimit dhe të kualifikimeve të stafit të Autoritetit, për të cilat informon këshillin drejtues;

g) miraton manuale dhe/ose procedura me karakter tekniko-operacionale;

gj) në fund të çdo tremujori, drejtori ekzekutiv i paraqet këshillit drejtues:

i) një raport për veprimtarinë e tij gjatë tremujorit;

ii) pasqyrat përkatëse për realizimin e treguesve financiarë të të ardhurave dhe shpenzimeve

kundrejt planifikimit;

iii) një raport të hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, për rastet e refuzimit të licencave, për të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të tjera, qoftë nga operatorët, qoftë nga konsumatorët, që i janë paraqitur Autoritetit.".

Neni 3

Në nenin 16 "Organizimi dhe detyrimet", pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"2. Marrëdhëniet e punës për stafin e Autoritetit rregullohen sipas Kodit të Punës dhe akteve të miratuara nga këshilli drejtues për procesin e rekrutimit dhe kërkesat e punësimit.

3. Rekrutimi i nëpunësve të Autoritetit bëhet në bazë të kërkesave dhe përshkrimeve të punës për çdo pozicion, të miratuara nga këshilli drejtues dhe të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Procedurat e rekrutimit duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për funksionimin e administratës.".

Neni 4

Në nenin 18, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"2. Drejtori ekzekutiv paraqet për miratim në këshillin drejtues propozimin me hollësi të programit financiar për vitin pasardhës, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit përkatës.

3. Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimtarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. Në vitet në vazhdim, të ardhurat e realizuara e të papërdorura, deri në fund të vitit, mbarten e përdoren për shpenzime të angazhuara deri për një periudhë 3-mujore të vitit pasardhës e më pas derdhen në Buxhetin e Shtetit.".

Neni 5

Në nenin 20, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Autoriteti i paraqet paraprakisht ministrit çdo raportim, për të cilin është i ngarkuar të raportojë direkt pranë organizmave ndërkombëtarë të aviacionit civil.".

Neni 6

Në nenin 22, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Çdo informacion tjetër, për të cilin nëpunësit e Autoritetit kanë dijeni, për shkak të funksionit dhe detyrave që kryejnë, duhet të administrohet prej tyre, në përputhje me rregullat e brendshme dhe hierarkinë e raportimit në Autoritet.".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7166, datë 24.11.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi